

Partizani/ Firmos per dy vite kosovari Liridon Ahmeti

nga AlbaniaSoccer

E martë, 07 Janar 2014 23:17



Partizani ka arritur akordin me Liridon Ahmetin. Mbrojtësi kosovar do të jetë pjesë e të kuqve për dy sezonet në vijim falë kontratës së nënshkruar më së fundmi të martës me drejtuesit e klubit. Përgjatë gjysmës së parë të këtij sezoni lojtari 28 vjeçar ishte pjesë e Llamkos Kosova, ekipi i cili aktualisht kryeson Superligën Kosovare. Pas sulmuesit Ersen Sali, Ahmeti është zyrtarisht përforcimi i dytë i Partizanit në merkatonë e Janarit. Në vazhdim të kuqetë pritet të afrojnë edhe lojtare të tjera. Aktualisht tek Partizani në provë është edhe sulmuesi boshnjak Almir Pliska.